



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 313/8 Prot.

Tiranë më, 22/10 / 2020

VENDIM

Nr. 20, datë 22.10.2020

“Për mënyrën e ndjekjes së procedurave të prokurimit kontrata shërbimi/blerje”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në mbledhjen e tij të radhës Bordi i Administrimit.

VENDOSI:

1. Të ndiqet çdo shërbim apo blerje që kryhet në ASA me procedurë përkatëse dhe të finalizohet me raportin e marrjes në dorëzim dhe të përfundimit të këtij shërbimi të firmosur nga personat që ndjekin këtë kontratë.
2. Në vijimësi, çdo procedurë për të cilën jepet fond nga shteti, duhet të jetë e përmbyllur me raport të imtësishëm mbi shërbimin/punën/blerjen e kryer, personat përgjegjës të ngarkuar me ndjekjen dhe realizimin e saj.
3. Ngarkohet administratori i ASA-së për ndjekjen e të gjithë procedurave bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Heliona MICO

